



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 163, datë 03.11.2023

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.150, DATË 22.12.2022, “MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 19.01.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.587, datë 18.10.2023 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion rruga “Apulia” (paralel me linjën hekurudhore -Plazh), Bashkia Durrës”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi për Menaxhimin Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Rishpërndarjen e fondeve të shpenzimeve korrente dhe kapitale ndërmjet programeve buxhetore sipas pasqyrës, tabela nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

## KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 06.11.2023**



tabela I :  
**SHPERNDARJA E FONDEVE PER SHPENZIME KORRENTE DHE KAPITALE NDERMJET PROGRAMEVE BUXHETORE PER VITIN 2023**  
 NE LEKE

Prog.	Kap	Art.	Kodi Inst	Njesia shpenzuese	Kodi Projektit	Emertimi i Projektit	Shtese 2023	Pakesim 2023
04220	5	231	2107001	Bashkia Durrës	1071534	Infrastrukturë për sektorin e bujqësisë		25,051,720
04520	5	231	2107014	Ndermarja Rruga	1071536	Blerje Asfalto-beton per rruge urbane dhe rurale		5,047,800
04520	5	231	2107014	Ndermarja Rruga	1071537	Blerje materiale inerte per mirembajtje rrugesh urbane dhe rurale		88,200
06260	5	231	2107014	Ndermarja Rruga	1071570	Blerje stola		400,240
06260	5	231	2107014	Ndermarja Rruga	1071572	Blerje autobot 2 cope per Nd.Rruga		360,000
								<b>30,947,960</b>
04520	5	231	2107001	Bashkia Durrës		Shpronësim për pasuritë pronë private që preken nga investimi publik me objekt : "Rikonstrukcioni rruga Apulia paralel me linjën hekurudhore-Plazh"	21,411,720	
01110	5	602	2107001	Bashkia Durrës		Shpenzime operative	1,500,000	
04240	5	231	2107014	Ndermarja Rruga		Punime riparimi në pusetën e komandimit rezervuari Tapana	2,140,000	
04520	5	602	2107014	Ndermarja Rruga		Shpenzime operative	5,896,240	
							<b>30,947,960</b>	-





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 709 / Prot.  
3

Durrës, më 13.11.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.163 datë 03.11.2023 “Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e këshillit bashkiaknr.50, datë 22.12.2022, “Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023” ”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

